



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Predato Received / Delivered	29.07.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlycja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	4428/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.549/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën e datës 20.06.2022 me numër A.nr.549/2022 të parashtruar nga ankuesi

në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.549/2022 e datës 20.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar ne Ministrinë e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, sipas Akt emërimit të datës 04.05.2012 në vendin e punës "Zyrtar i arsimit të mesëm të ulët" në Departamentin e Administratës së Arsimit Para universitar, U.d. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me datë 27.01.2021 nxjerr vendim me numër 2-101, me të cilin vendim ankuesit i aprovohet nivelizimi i koeficientit nga shtatë (7) në tetë (8), duke u bazuar në shkresën e DASHC/MAP 04/530-02/ZSP/1501 të datës 23.01.2017 dhe shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të datës 25.01.2021.

Zyra e Personelit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me datë 21.04.2021 përmes emailit e njofton ankuesin se kane dërguar kërkesën për procesimin e

ndryshimeve në pagë në bazë të Vendimit me numër 2-101 të datës 27.01.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, por që sistemi i pagave nuk e ka realizuar ngritjen e koeficientit.

Po ashtu, Zyra e Personelit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me datë 01.04.2022 bene plotësim ndryshimin e akt emërimit për ankuesin që përfshinë titullin e vendit të punës sipas katalogut në fuqi dhe koeficientin përkatës

Ankuesi i pa kënaqur me mos zbatimin e Vendimit me numër 2-101 të datës 27.01.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe kompensimin gjegjësisht pagesën retroaktive nga muaji mars -prill i vitit 2022 e jo nga momenti i hyrjes në fuqi të Vendimit me numër 2-101 të datës 27.01.2021, me datë 20.06.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 3588/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.06.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Më datë 08.07.2022 organi i punësimit ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 20.06.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 27.01.2021 të U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Plotësim/ndryshimi i akt emërimit i datës 01.04.2022; e-mail i datës 21.04.2021; Akt emërimi i ankuesit i datës 04.05.2012; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Lista e pagave për muajin janar, shkurt, dhjetor të viti 2021; lista e pagave për muajin mars, prill, maj të vitit 2022 i dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e *jashtëafatshme, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 04.05.2012 është i sistemuar në vendin e punës "Zyrtar i arsimit të mesëm të ulët" në Departamentin e Administratës së Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me datë 27.01.2021 ka nxjerr vendim me numër 2-101 me të cilin vendim ankuesit i është aprovuar nivelizimi i koeficientit nga shtatë (7) në tetë (8) duke u bazuar në shkresën e DASHC/MAP 04/530-02/ZSP/1501 të datës 23.01.2017 dhe shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të datës 25.01.2021.

Zyra e Personelit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me datë 01.04.2022 bene plotësim ndryshimin e akt emërimit për ankuesin që përfshinë titullin e



vendit të punës sipas katalogut në fuqi dhe koeficientin përkatës dhe e njofton ankuesin që ndryshimet gjegjësisht pagesa retroaktive do ti bëhet nga muaji prill i vitit 2022.

Ankuesi me datë 20.06.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 3588/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor që ti njihet pagesa retroaktiv nga data e nxjerrjes së vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm për nivelizim të pagës nga shtatë (7) në tetë (8), konkretisht nga data 27.01.2021 e jo nga muaji prill i vitit 2022 siç e ka njoftuar Zyra e Personelit të MASHT.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 1 përcakton se: ***“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”***, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill është jashtë afati siç përcaktohet me nenin 127 paragrafi 1 të Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që ankuesi deklaroi në ankesë se i njëjti ka qenë i njoftuar me përmbajtjen e aktit të nxjerrë me datë 01.04.2022 dhe po ashtu akti i njëjtë nuk ka paraparë kompensim retroaktiv për ankuesin, andaj mbi këtë bazë nga momenti kur ankuesi është njoftuar me përmbajtjen e aktit në fjalë të datës 01.04.2022 kanë kaluar më shumë se 30 ditë, respektivisht ankesa e ankuesit e datës 20.06.2022 me numër të protokollit 3588/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me njohjen e të drejtës së kompensimit në mënyrë retroaktive sipas Vendimit të datës 27.01.2021 me numër 2-101 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë pasi që mbi bazën e të njëjtit është bërë edhe plotësim ndryshimi i aktit të emërimit me datë 01.04.2022, dhe në bazë të dëshmive të ofruara ka konstatuar se ankuesi Vendimin me numër 2-101 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e ka pranuar me datë 27.01.2021, ndërsa ankesën me numër të protokollit 3588/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me datë 20.06.2022 jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: ***„Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”***. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afatit prej ***tridhjetë (30) ditëve*** në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës respektivisht Kolegji konstaton se momenti kur ankuesit ka filluar ti rrjedhë afati ligjor për ankimim është kur ka kuptuar se kanë kaluar më shumë se 30 ditë pas pranimit të vendimit dhe i njëjti nuk ka prodhuar efekte juridike në favor të ankuesit dhe mbi këtë bazë Kolegji njëzëri konstaton se ankesa e ankuesit hedhet poshtë si e pa lejuar.




Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.549/2022

Flakron Gashi



Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit e Shkencës e Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Udhëheqësës së Personelit në Ministrinë së Arsimit e Shkencës e Teknologjisë dhe Inovacionit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

